



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 208, datë 24.12.2024

PËR
MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUTIT TË SHOQËRISË “CREDINS INVEST”
SH.A. - SHOQËRI ADMINISTRUESE E FONDEVE TË PENSIONIT PRIVAT DHE
SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE, SI REZULTAT I RRRITJES SË
KAPITALIT

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të pika 22, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të nenit 20, të ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, nenit 17, të ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”, rregullores nr. 112 datë 31.08.2020 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, si dhe rregullores nr. 1, datë 31.01.2024 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat dhe depozitarit të fondeve të pensionit privat të themeluara në Republikën e Shqipërisë” Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e ndryshimit të nenit 5, të statutit të shoqërisë “Credins Invest” sh.a. - Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, si rezultat i ndryshimit të strukturës aksionare, me këtë përmbajtje:

“Neni 5 - Kapitali i Shoqërisë

- 5.1 *Kapitali i nënshkruar dhe i paguar tërësisht i shoqërisë është 95,822,394.00 lekë i përbërë prej 233,713.00 aksione me vlerë nominale 410 (katërqind e dhjetë) lekë secili.*
- 5.2 *Kapitali aksionar i shoqërisë përbëhet tërësisht nga kontribute në para (likuide) dhe zotërohet nga aksionarët e shoqërisë si më poshtë vijon:*
- Pjesëmarrja aksionare e “Banka Credins” sh.a., është në nivelin 76.00%, të kapitalit aksionar me barasvlerën në lekë prej 72,825,019 si dhe me 177,622 aksione.*
 - Pjesëmarrja aksionare e zj. Estela Koçi, është në nivelin 8.00%, të kapitalit aksionar me barasvlerën në lekë prej 7,665,790 si dhe me 18,697.05 aksione.*

- c) *Pjesëmarrja aksionare e z. Egi Santo, është në nivelin 6.8%, të kapitalit aksionar me barasvlerën në lekë prej 6,515,921 si dhe me 15,892.49 aksione.*
- d) *Pjesëmarrja aksionare e z. Genc Koxhaj, është në nivelin 6.8%, të kapitalit aksionar me barasvlerën në lekë prej 6,515,921 si dhe me 15,892.49 aksione.*
- e) *Pjesëmarrja aksionare e zj. Armira Çitozi, është në nivelin 1.4%, të kapitalit aksionar me barasvlerën në lekë prej 1,341,512 si dhe me 3,271.98 aksione.*
- f) *Pjesëmarrja aksionare e zj. Vjosa Mujo, është në nivelin 1%, të kapitalit aksionar me barasvlerën në lekë prej 958,231 si dhe me 2,337.15 aksione”.*

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, Departamenti i Licencimit, Mbrojtjes Konsumatore dhe Sjelljes së Tregut, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR

Idlir GJATA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Mimoza KAÇI